

## PROÇESVERBAL I MBLEDHJES DATËS 13 MARS 2026

Kryesuesi I mbledhjes është: Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi

Ora e hapjes së mbledhjes: 11:00

Zhvillimi i mbledhjes: Në sallën e Këshillit Bashkiak

Këshilltarë pjesëmarrës në momentin e hapjes së mbledhjes: 25

Sekretari i Këshillit deklaroi kourumin prej këshilltarësh: 25

Të pranishëm nga administrata e Bashkisë: Kryetari i Bashkisë Sotiraq Filo dhe Drejtorë të Administratës.

Të pranishëm në mbledhje qytetarë: 0

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Mirëdita të gjithëve fillojmë këtë mbledhje jashtërradhe të Këshillit Bashkiak, Materialet janë shpërndarë. Kush është dakort me rendin e ditës?

### **Pika 1 e rendit të ditës.**

PËR MIRATIMIN E RENDIT TË DITËS.

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 25

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Sekretari i Këshillit E.Naçi: Janë 25 këshilltarë, 25 pro, 0 kundër, 0 abstenim.

### **Pika 2 e rendit të ditës.**

“PËR MIRATIMIN E RITJES TË PLANIT TË TË ARDHURAVE DHE PËRDORIMIN E FONDIT TË FINANCUAR NGA KËSHILLI I QARKUT PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT STIMULIM I INDUSTRIVE KREATIVE NË QYTETIN E KORÇËS.”

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Ju lutem komisioni z.Altin Habip.

Këshilltar A.Habip: Bashkia ka dërguar relacionin për rritjen e planit të të ardhurave në shumën 4 milion lekë sipas një marrëveshje midis Këshillit të Qarkut dhe Bashkisë të datës 9 shkurt 2026, në bazë të së cilit Këshilli i Qarkut financon projektin për stimulimin e industrisë kreative në qytetin e Korçës. Kjo shumë do përdoret për të krijuar një hapësirë të dedikuar për zejtarinë tradicionale dhe për pagimin e qirasë të aktivitetit që do të bëhet.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Faleminderit, ka pyetje nga këshilltarët, nëse jo po ja jap fjalën kryetarit të Bashkisë për një shpjegim.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Faleminderit për këtë mbledhje jashtërradhe për të shqyrtuar këtë material të cilin e gjykoj shumë të rëndësishëm siç edhe e prezantova në mbledhjen e fundit. Ideja e këtij projekti është të mbështes industrinë kreative dhe artizanatit, në qytetin e Korçës me dy objektiva kryesore. E para për ta mbështetur këtë lloj industrisë dhe e dyta të kemi mundësinë t'i përdorim edhe në funksion të një produkti turistik në fushën e turizmit të eksperiencës. Konkretisht nëpërmjet këtij projekti synohet vendosja e një grupi biznesesh që përfshihen në spektrin e industrive kreative, artizanat, industry videosh në zonën e Pazarit të Vjetër të Korçës. Me anë të këtij projekti synohet të merret me qira nga ana e Bashkisë një numër objektesh private dhe pastaj ndërmjet një procedure përzgjedhje të përzgjidhet një grup biznesesh që do vendosen tek këto objekte për të zhvilluar aktivitetin e tyre. Përfitimet janë në dy drejtimet që përmenda. Dua nëpërmjet këtyre grupeve që do vendosen në Pazar të krijojmë një paketë të turizmit të eksperiencës, turistët kur të kalojnë tek kjo zonë të kenë mundësi dhe të shohin sesi prodhohen këto produkte artizanati të kenë mundësi edhe të ndërveprojnë dhe të kenë mundësi të blejnë dhe suvenire të cilat janë të prodhura në mënyrë artizanale. Një model i ngjashëm është modeli që kanë bërë këto vajzat e kompanisë që prodhojnë tapete dhe qilimi, kanë marrë një objekt dhe në katin e sipërm kanë vendosur atë vegëlën që prodhojnë qilimat duke ja treguar dhe vizitorëve dhe katin e poshtëm e kanë edhe si ekspozitë ku blihen këto produkte. Ne duam të bëjmë të njëjtën gjë në shkallë më të gjërë punime të fushave të ndryshme, t'i vendosim atje dhe ta zhvillojmë këtë aktivitetet tek dy komponentët që thashë. Unë e gjykoj shumë projekt të rëndësishëm tek dy komponentët, vazhdimisht kemi diskutuar tek mbledhjet e Këshillit se çfarë mund të bëhet më tepër në fushën e turizmit, çfarë do kërkonin vizitorët e huaj se çfarë do kishin interes të vizitonin qytetin tonë. Me ato që kam folur edhe me operatorët turistik të niveit kombëtar, fusha e turizmit të eksperiencës është një nga gjërat që kërkohet dhe vlerësohet. Prandaj shpresoj edhe besoj se ky projekt do i vlejë edhe ruajtjes të artizanatit edhe nxitjes të turizmit në qytet,. Ju ftoj ta votoni, dua të falenderoj edhe Këshillin e Qarkut për mbështetjen që na ka dhënë .

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Faleminderit, ka pyetje nga këshilltarët?

Nëse jo hap procesin e votimit.

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 24

Vota KUNDËR 2

Vota ABSTENIM 0

Sekretari i Këshillit E.Naçi: Janë 26 këshilltarë, 24 pro, 2 kundër, 0 abstenim.

### **Pika 3 e rendit të ditës.**

“PËR PROPOZMIN E NDRYSHIMIT TË VKM-SË NR.377 DATË 10.07.2025 PËR TRANSFERIMIN E DISA PRONAVE NË PRONËSI TË BASHKISË KORÇË DHE DISA

NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.1532 DATË 19.11.2008 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI TË BASHKISË OSE QARKUT KORÇË, TË NDRYSHUARA”.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Meqënëse kourumi nuk u bë për mbledhjen e komisionit një shpjegim nga ekzekutivi. Këtu gjej rastin t’ju falenderoj edhe ju këshilltarëve që vini ndoshta në të ardhmen me ndryshimin e këshilltarëve në komision të riformatojmë edhe njëherë këtë komision.

Drejtorja Juridike A.Qermaxhi.Dishnica: Me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.377 të vitit 2025 janë transferuar në pronësi 5 prona, 4 prej tyre na janë vendosur dy kufizime ndalimi i ndryshimit të destinacionit dhe ndalimi i tjetërsimi i pronave. Kjo është hera e parë që na ndalohet tjetërsimi dhe duke gjykuar se na cënohen gjitha tagrat e pronarit e drejta për ta tjetërsuar, ne propozojmë që të bëjmë një ndryshim duke hequr ndalimin e tjetërsimit të pronave sepse të paktën për dy nga këto prona kanë destinacion strehimin dhe ndërtimin e banesave sociale dhe mund t’ju transferohen dhe të tretëve. Nuk kemi diçka konkrete për destinacionin e tyre por kërkojmë të hiqet tjetërsimi. Numrat kadastrale të pronave i keni në material.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Faleminderit, ka pyetje nga këshilltarët?

Këshilltare M.Qeleshi: Me sa kuptova nga materiali, domethënë ishin pesë prona që transferoheshin nga të cilat dy prona do bëni heqjen e kufizimit, kështu e kuptoj.

Transferohen pesë, katër do ndryshoni se shembull keni marrë dy , do bëni ndryshim kufizim të drejtash në katër prej tyre?

Dy na i keni shpjeguar që është 966 dhe 968, dy të tjerat janë 966, 967 dhe 969, këto nuk i keni shpjeguar në material. Ndoshta dhe për sqarim sepse nuk jam jurist, pashë këtë vkm e korrikut edhe ju thoni që mund të bëhet për banesa sociale. Në vkm ishin këto katër prona nuk ishte ajo e Dërsnikut ajo kishte shpjegim tjetër, nuk ka problem, nuk po merrem me këtë. Në tabelën e vkm-së për 966 dhe 968 të cilat ju i shpjegoni., 966 në funksion thotë truall në rruga “Midhi Kostani” më duket është kjo 2000 m, ndërtim banesa sociale dhe strehim. Cfarë i ndryshoni edhe 968, sheshi në Mbroje dhe kjo thotë për strehim. Atëherë ku është, domethënë theksohet ai ndryshimi që ju duhet të bëni, ndoshta mund ta kem pyetje gabim por duke qënë se citoni të njëjtën shprehje dhe në vkm, çfarë do ndryshojë?

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Nuk po kërkojmë të ndryshojmë destinacionin e përdorimit të pronës. Prona ka destinacionin ka edhe kufizim. Destinacionin nuk do e ndryshojmë, po kërkojmë të hiqet kufizimi që i është vendosur pronës për tjetërsim sepse në varësi të formulës të menaxhimit të x prone mund të lindë nevoja të bëhet edhe tjetërsim, bashkëpunim. Nuk do ndryshojmë destinacionin, vetëm të heqim kufizimin, sepse mesa shpejtoi Anxhela është hera e parë që na i kalojnë me këto lloj kufizimi, mbase kanë bërë gabim, nuk e di.

Këshilltare M.Qeleshi: Domethënë ne si Këshill Bashkiak e kemi të drejtën të ndryshojmë vkm-në?

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Të propozojmë, do bëhet prapë me vkm.

Këshilltare M.Qeleshi: Ok, ndiqni shkallët proceduriale.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Duhet ta miratojë Këshilli i Bashkisë.

Këshilltare M.Qeleshi: Ndoshta kjo prona 966, në Bulevard “ Republika” cila pronë është konkretisht, për aktivitetet social- kulturor?

Drejtoria Juridike A.Qermaxhi.Dishnica: Kati i parë i Qendrës Rinore.

Këshilltare M.Qeleshi: Tre ishin në fshat, njëra në “ Midhi Kostani” dhe ish-Shtëpia e Oficerave. Po për 902 të Dërsnikut nuk keni ndonjë informacion, sepse nuk përmendet?

Drejtoria Juridike A.Qermaxhi.Dishnica: Nuk ka kufizim për atë.

Këshilltare M.Qeleshi: Domethënë ju dy pronat na i dhatë në material që mendoni të kenë këtë destinacion. Dy të tjerat kur të vijë rradha do i miratojmë prapë ato?

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Patjetër.

Këshilltar A.Përmeti: Një shpjegim, me vendim pronat i kanë kaluar Bashkisë me destinacion dhe kanë kufizim. Tani ne kërkojmë të hiqet kufizimi me vendim për tjetërsim dhe e kemi kuadrin ta bëjmë këtë dhe t’ja drejtojmë Ministrisë përkatëse?

Drejtoria Juridike A.Qermaxhi.Dishnica: ( Nuk ka audio, flet pa mikrofon.)

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Faleminderit, ka pyetje nga këshilltarët?

Nëse jo hap procesin e votimit.

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 24

Vota KUNDËR 3

Vota ABSTENIM 0

Sekretari i Këshillit E.Naçi: Janë 27 këshilltarë, 24 pro, 3 kundër, 0 abstenim.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Kjo ishte pika e fundit e rendit të ditës. Falenderoj këshilltarët që morën pjesë. Një kujtesë për ditën e martë dhe të mërkurë, janë ditët e konsultimit public, materialet janë dërguar me email, ju lutem këshilltarëve sipas zonave dhe komisioneve të jenë prezent. Njëra do zhvillohet në Mollaj datë 17 dhe tjetra në datën 18 në salla e Këshillit Bashkiak. Faleminderit, mirë u takofshim!

SEKRETARE E KËSHILLIT EVA NAÇI

KRYETARE E KËSHILLIT BASHKIAK ANA VERUSHI